




REPUBLIKA E KOSOVËS AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT ANTI-CORRUPTION AGENCY		REPUBLIC OF KOSOVO AGENCY AGAINST CORRUPTION ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D/OPK	Nr. Prot.	01-697/16
Dep.		Prokurim	
Nr. llog.		Data	23.02.2016
Broj. stranica	03	Datum	
Nr. pages		Data	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	23/02/2016
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Nazmije PAÇARIZ Menaxhere e Zyrës së Prokurimit në Spitalin e Përgjithshëm "prim.dr. Daut Mustafa"
CC:	z. Afrim AVDAJ Drejtor Ekzekutiv në Spitalin e Përgjithshëm "prim.dr. Daut Mustafa"
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Furnizim me material administrativ"

E nderuara znj. Paçariz,

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nënpar. 1.1. dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nënpar. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nënpar. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin lidhur me Tenderin "**Furnizim me material administrativ**" me numër prokurimi: 70010 16 002 121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "**Furnizim me material administrativ**" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik dhe të akteve tjera nënligjore që derivojnë nga ky ligj.

A r s y e t i m

Spitali i përgjithshëm "Prim.Dr. Daut Mustafa" në Prizren, si Autoritet Kontraktues ka përgatit Njoftimin për Kontratë me titull: "**Furnizim me material administrativ**" me numër të prokurimit: 70010 16 002 121. Ky aktivitet i prokurimit më datë 01/01/2016 është publikuar në web faqen e Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik. Agjencia kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë aktivitet Prokurimi si rast për trajtim dhe gjatë ekzaminimit të aktivitetit të prokurimit nga Dosja Tenderit, Agjencia kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në përputhje të plotë me Procedurat e Prokurimit në Kosovë.

Gjatë shfletimit të dokumentacionit për këtë aktivitet të prokurimit Agjencia kë vërejtur se tek Aneksi I i Dosjes së Tenderit, Specifikimet Teknike të Detyrueshme në pozicionin me nr.53, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar "Lapsa kimik të kualitetit të lart SHNAJDER".

Bazuar në legjislacionet në fuqi për Prokurim Publik me përcaktimin e emrit të prodhuesit të këtyre mallrave, mund të favorizohen prodhuesit e caktuar dhe në të njëjtën kohë diskriminohen prodhuesit tjetër. Autoriteti Kontraktues mund të kërkoj që produkti të jetë i kualitetit të lartë dhe mund ti referohet një standardi vendor, European ose ndërkombëtar, por nuk lejohet assesi të kërkohej emërtimi i të këtyre mallrave.

Njësia kërkuese pranë Autoritetit kontraktues duhet të ketë kujdes që me rastin e formulimit të specifikimeve teknike të mos formuloj specifikime favorizuese për prodhues të caktuar e në të njëjtën kohë ti diskriminoj Operatorët tjerë ekonomik.

Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Agjencia Kundër Korrupsionit pasi ka analizuar me kujdes pjesën e specifikimeve teknike të detyrueshme për këtë aktivitet të prokurimit ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues në pozicionet me nr.32-38 ka parapa edhe furnizim me toner për printer dhe furnizim me toner për aparate fotokopjuese. AKK konsideron furnizimi me mallra të tillë kërkon zhvillim të aktiviteteve të ndara pasi që për kryerjen e këtyre furnizimeve nevojiten Operatorë Ekonomik të profilin përkatës. Po ashtu tek Pjesa II.

Për këtë aktivitet të prokurimit Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit tek Seksioni II. Fleta e të dhënave të tenderit në rubrikën 13.2-Siguria e Tenderit, ka kërkuar sigurinë e tenderit në vlerë prej 2,000.00€ me periudhë valide prej **60 ditë**, si dhe tek rubrika 21.1 Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë **60 ditë**.

Bazuar në legjislacionet në fuqi për Prokurim Publik, siguria e tenderit do të qëndroj valid për një periudhë prej tridhjetë(30) ditë pas skadimit të periudhës së validitetit të tenderit. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues do të duhej që validitetin e sigurisë së tenderit ta kërkonte në periudhë prej 90 ditëve.



Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, nenin 28 Specifikimet teknike të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237 si dhe nenin 26 Sigurimi i Tenderit të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!

